



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/Republic of Kosovo  
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 020/61-31436/24  
Dt. 10.12.2024

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në përputhje me nenet 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 57 të Statutit të Komunës së Dragashit Nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M

### PËR THJESHTËZIMIN E SHËRBIMEVE NË KOMUNËN E DRAGASHIT

- I. Me këtë Vendim synohet thjeshtimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Dragashit.
- II. Në të gjitha rastet kur qytetari bën kërkesë për një shërbim administrativ, për nxjerrjen e të cilit kërkohet një dokument që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër e komunës, zyrtari përkatës i komunës obligohet që dokumentin e tillë të mos e kërkojë nga pala.
- III. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si kopje, atëherë zyrtari përkatës kërkon dokumentin për shikim nga pala, dokumenti kopjohet nga ana e zyrtarit dhe vendoset në dosje. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si origjinal, atëherë zyrtari përkatës e vendos në dosje, por nuk e kërkon nga pala.
- IV. Të gjitha shërbimet administrative për nxjerrjen e të cilave kërkohen dokumente mbështetëse që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës janë të paraqitura në Shtojcën 1 të këtij Vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi dhe zbatohet nga data 01 janar 2025.

Vendimi i dërgohet:

- Të gjithë drejtorive komunale që ofrojnë shërbimet sipas Shtojcës 1
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Zyrës së Kryeministrit



Kryetari i Komunës  
Bexhet Xheladini

**Shtojca 1: Shërbimet e thjeshtuara të Komunës së Dragashit**

Nr.	EMRI I SHËRBIMIT	EMRI I DOKUMENTEVE QË NUK KËRKOHEN MË PËR MARRJEN E SHËRBIMIT
<b>DREJTORIA E ADMINISTRATËS</b>		
1.	Ndërrimi apo korrigjimi i emrit, mbiemrit dhe vendbanimit	1. Ekstrakti i lindjes 2. Çertifikatë e martesës 3. Ekstrakt apo çertifikatë martesë nëse korrigjimi duhet bërë në rubrikën e prindërve 4. Çertifikatë që personi nuk është nën hetime
2.	Regjistrimi i fëmijës i lindur jashtë vendit	1. Ekstraktet e lindjes së prindërve 2. Çertifikata e martesës së prindërve 3. Kopjet e letërnjoftimeve të prindërve (Njeri prind me shtetësi Kosovare duhet të ketë)
3.	Regjistrimet e mëvonshme	1. Ekstraktet e lindjes së prindërve 2. Çertifikata e martesës së prindërve 3. Raporti mjekësor i fëmijut 4. Kopja e dokumentit të identifikimi
4.	Tarifa për pjesëmarrje në procedurat tenderuese – material tenderues për një operator ekonomik	Hiqet si shërbim
<b>DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE</b>		
5.	Deklarata mbi bashkësinë familjare	1. Kopja e letërnjoftimit
6.	Certifikatë vendbanimi	1. Kopja e letërnjoftimit
7.	Vërtetim i fotokopjeve krahasuar me origjinalin në faqe	Hiqet si shërbim
8.	Vërtetim për leje për armë	1. Kopja e letërnjoftimit
9.	Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës	1. Kopja e letërnjoftimit
10.	Vërtetim që nuk është nën kujdestari (punësim)	1. Kopja e letërnjoftimit 2. Raporti i mjekut fotokopje
11.	Vërtetim që nuk është nën kujdestari (praktikant në oden e avokateve)	1. Kopja e letërnjoftimit 2. Dëshmi diploma universitetit.
12.	Vërtetim për bashkim familjar	1. Kopja e letërnjoftimit
13.	Vërtetim që personi nuk merr asistencë sociale	1. Letërnjoftimi kopje
14.	Vërtetim që personi nuk merr asistencë sociale (për pranimin e shtetësi të Kosovës)	1. Kopja e letërnjoftimit 3. Çertifikata e vendbanimit.
15.	Pëlqim për udhëtime jashtë vendit për fëmijët	Hiqet si shërbim

16.	Pëlqim për martesë para moshës madhore	Hiqet si shërbim
17.	Pëlqim për dokumente të udhëtimit	Hiqet si shërbim
<b>DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT</b>		
18.	Informime lidhur me parcelat në HZK, ekstrakte nga „PRRU” SHARRI	1.Letërnjoftimi (Fotokopje)
19.	Kopje plani	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
20.	Lista poseduese	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
21.	Nxjerrja e aktvendimeve dhe pezullimeve për ndarjen e parcelave, bashkimin, regjistrimin e ndërtesave, rirregullimin e kufijve etj	Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
22.	Regjistrimi paluajtshmërive, hipotekave, barra tatimore, ndalesa gjyqësore etj.	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
23.	Identifikimi parcelave dhe regjistrimi në pjesën grafike	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
24.	Shqyrtimi kërkesave për korrigjimin e regjistrave kadastrale	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
25.	Dhënia e produkteve (marrja e koordinatave)	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave
26.	Certifikata që nuk ka paluajtshmëri	1. Letërnjoftimi (kopje)
<b>DREJTORIA E MBROJTJES, SHPËTIMIT DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE</b>		
27.	Pëlqimi për gërmim/dëmtim të rrugës (asfalt, bloqe, sipërfaqe me gjelbërim) për kyçje në ujësjellës kanalizime.	1.Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë - person fizik
28.	Pëlqimi për gërmim/dëmtim rruge (asfalt, kupolë, zonë jeshile) për energji	4.Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë - person fizik 5.Vërtetim për pagesën e taksës komunale - person juridik
29.	Pëlqimi për shfrytëzimin e hapësirës publike në shtylla me kablo elektrike dhe telekomunikuese - (për të marrë leje nga DUPH)	4.Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë - person fizik 5.Vërtetim për pagesën e taksës komunale - person juridik
30.	Pëlqimi për përdorimin e një zone publike me kabinete dhe pajisje të tjera për energji dhe telekomunikacion (për të marrë leje nga DUPH)	4.Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë - person fizik

		5.Vërtetim për pagesën e taksës komunale - person juridik
31.	Instalimi i antenave të operatorëve për telekomunikacion, në hapësira publike dhe private	4.Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë - person fizik 5.Vërtetim për pagesën e taksës komunale - person juridik
32.	Kundërshtim për shkak të mos kryerjes së shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave	2.Kopja e letërnjoftimit
33.	Instalimi i ndriçimit publik (duke përfshirë ndërrimin e llambave, infrastrukturën e re, etj.)	2.Kopja e letërnjoftimit
34.	Leje për bllokim rrugësh - (ose për të hapur kanalizime ose për të prishur një ndërtesë)	2.Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë - person fizik 3.Vërtetim për pagesën e taksës komunale - person juridik
35.	Leje për transport qytet-periferi	7.Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë
36.	Vendim për oraret e autobusëve për transportin në mes qyteteve	4.Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë - person fizik 5.Vërtetim për pagesën e taksës komunale - person juridik
37.	Lëshimi i vërtetimit për shërbimin ushtarak	Hiqet nga shërbimi
<b>DREJTORIA PËR BUJQËSI, TURIZËM, ZHVILLIM RURAL DHE INSPEKSION</b>		
38.	Kontrolli i shëndetit të kafshëve para therjes dhe dhënja e lejes për shitjen e mishit për kafshë e mëdha për copë	Hiqet nga shërbimi